

VENDIM
Nr. 604, datë 25.10.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 113, DATË 6.3.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE QË
PËRFAQËSOJNË PALËN SHQIPTARE NË KOMISIONIN SHQIPTARO-
MALAZEZ PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE ME INTERES TË PËRBASHKËT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të kreut III, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 113, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në Komisionin Shqiptaro-Malazez për Menaxhimin e Ujërave me Interes të Përbashkët”, në pikën 1 të tij, shkronjat “c”, “ç”, “e”, “ë” dhe “P” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) Z. Armand Skapi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

ç) Z. Klodian Zaimi, Instituti i Gjeoshkencave;

...

e) Znj. Sonila Marku, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;

ë) Znj. Evis Mellonashi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

f) Z. Besmir Kullolli, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”.

2. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Instituti i Gjeoshkencave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku